

Programet akademike në fushën e trafikut dhe transportit në Institucionin e Kolegjit “TEMPULLI” , si dhe ne kete kontekst, ofrimi programeve akademike në fushën e trafikut dhe transportit, si kusht për qëndrueshmërinë e ambientit më të favorshëm ekonomik.

-
- ✘ Në Kosovë, sot nuk mund të mendohet ndonjë zhvillim i shpejt në lëminë e trafikut rrugor dhe transportit, trafikut postar dhe telekomunikacionit, pastaj, trafikut hekurudhor, komunikacionit ajror dhe së fundi, logjistikës e transportit dhe të infrastrukturës në përgjithësi, pa ekzistuar nevojë e menjëhershme për një shkollim të mirëfillt të kuadrove, të cilat që nga fillimi do të përgatiteshin profesionalisht në sferat përkatëse. Projektet për rehabilitimin dhe ndërtimin e rrugëve të reja që lidhin vendbanimet brenda Kosovës dhe jashtë saj, poashtu kërkojnë kuadro të profesionalizuara në këtë fushë.

-
- ✘ Qëllimi i këtyre lëmvive studimore, është bazuar në aftësimin e studentëve në ato lëmi, të cilat janë të domosdoshme për përgatitje profesionale nga lëmia e komunikacionit, infrastruktures, organizimit dhe udhëheqjes së komunikacionit, respektivisht lidhjes funksionale të infrastrukturës së komunikacionit, që janë parakushte për një zhvillim me domethenë ekonomik. Qarkullimet bashkëkohore të mallrave dhe njerëzve kërkojnë poashtu kombinimin e të gjitha degëve të transportit dhe një infrastrukturë të zhvilluar dhe funksionale të komunikacionit.

-
- ✘ Përmbajtja programore në studimet Bachelor dhe Master u mundëson studentëve që të fitojnë një bazë të zgjeruar të njohurive inxhinierike, aftësi dhe përvojë të mjaftueshme për punë individuale dhe kolektive gjatë zgjidhjes së problemeve konkrete në praktikë nga lëmia e komunikacionit, si dhe u mundëson bazë adekuate për vazhdimin e studimeve të më-tutjeshme.

-
- × “TEMPULLI” është institucioni i vetëm në Kosovë që zhvillon një numër të konsiderueshëm të programeve të akredituara dhe të licencuara studimore në Nivelin Bachelor, sic janë:
 - × 1. Trafiku Rrugor dhe Transporti - (TRRT),
(në Nivelet 4,5 dhe 6 sipas EQF-së).
 - × 2. Trafiku Postar dhe Telekomunikacioni - (TPT),
(në Nivelet 4,5 dhe 6 sipas EQF-së).
 - × 3. Trafiku Hekurudhor dhe Transporti – (THT),
(në Nivelet 4,5 dhe 6 sipas EQF-së).
 - × 4. Komunikacioni Ajror dhe Transporti – (KAT),
(në Nivelet 4,5 dhe 6 sipas EQF-së).
 - × 5. Logjistika dhe Transporti – (LT),
(në Nivelet 4,5 dhe 6 sipas EQF-së).

-
- × Studimet profesionale në të gjitha programet në nivelet 4, 5 dhe 6 zgjasin nga dy (2) deri në gjashtë (6) semestra (përkatësisht nga një vit deri në tri vite studimi).
 - ×
 - × Transporti dhe telekomunikacioni është program studimor në shkallën e studimeve Master, duke iu mundësuar studentëve që të studiojnë në tri fusha specializimi, dhe ato:
 - × 1. Transporti,
 - × 2. Siguria rrugore dhe aksidentet, dhe
 - × 3. Komunikacioni postar dhe telekomunikacioni.
 - ×
 - × Planet dhe programet studimore janë definuar sipas programit reformues, duke u bazuar në procesin e Bolonjës.

-
- ✘ Tempulli për herë të parë është akredituar me dt. 18 dhjetor 2001 nga Departamenti i Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë (Misioni i Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë). Përveç akreditimit nga Agjencia e Akreditimit e Kosovës (AAK) dhe licencimit nga Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHT), ka edhe dy akreditime ndërkombëtare, nga The Chartered Institute of Logistics and Transport – International (CILT) nga Mbretëria e Bashkuar dhe nga International Road Transport Union (IRU Academy) nga Zvicra.

-
- ✘ Arritja e këtij qëllimi është duke u realizuar përmes planeve dhe programeve studimore për studimet BACHELOR dhe MASTER, ku studenti njihet me metodat më bashkëkohore të punës hulumtuese aplikative, duke rritur performancën e tij profesionale me qëllim të pavarësimit sa më të madh në profesion.

- ✘ Kolegji “TEMPULLI” ka traditën më të gjatë në arsimin privat në Kosovë, meqë nga viti 1992, ketu punohet në aftësimin dhe edukimin e vijuesve në fushën e trafikut. Deri më tani kanë kaluar një numër i madh i studentëve si dhe vijuesve të kurseve të ndryshme profesionale, gje qe shpresojme, se është ndikuar në rritjen e punësimit dhe punësueshmërisë së kuadrove në Kosovë, në rritjen e sigurisë në komunikacion dhe në përmirësimin e cilësisë së ofertës së arsimit terciar, profesional dhe të lartë në Kosovë. Poashtu konsiderojmë, se këto vite kanë qenë vite të rritjes së pandërprerë të sasisë, cilësisë dhe përmbajtjes arsimore e aftësuese në Tempull.

-
- ✘ Për dallim nga vitet tjera, këtë vit “Tempulli” ka ofruar një ofertë studimi më të zgjeruar si për nga forma, ashtu edhe nga përmbajtja, kohëzgjatja dhe përmbajtja e programeve. Vëmendje e madhe i është kushtuar edhe zhvillimit profesional duke ofruar programe shumë interesante me qëllim të rritjes së kompetencës dhe zhvillimit të njohurive në profesion (mësimi gjatë gjithë jetës). Të gjitha këto programe do të jenë të krahasueshme dhe do të vlerësohen nga Agjencia e Kosovës për Akreditim, duke qenë të vlefshme për vazhdimin dhe zgjerimin e kapaciteteve profesionale dhe sidomos në punën praktike.

-
- ✘ Kurset janë përgatitur në atë mënyrë që arrijnë përmbajtjen optimale, duke kombinuar mirë njohuritë themelore teorike me punën dhe aftësitë profesionale praktike. Poashtu është arritur një lidhshmeri korekte e struktureve të këtyre programeve si në nivelin horizontal ashtu edhe në atë vertikal. Krejt kjo, me qëllim që për një kohë relativisht të shkurtër studentet e posa diplomuar të jenë në gjendje t'u përgjigjen plotësisht kërkesave në mjediset dhe ambientet e punës.
 - ✘ Meqë fokusi i kolegjit ka qenë në rradhë të parë të mesimdhënia, mësimnxënja si dhe përvetësimi i punës në praktikë, andaj rezultatet edhe nuk kanë munguar.

-
- × **Kolegji “TEMPULLI”** perspektivën e vet e ka mbeshtetur në:
 - × -hapjen tejet më të gjerë ndaj arritjeve tekniko-teknologjike dhe shkencore botërore;
 - × -bashkëpunimin më të madh dhe të vazhdueshëm me universitetet evropiane, ato amerikane dhe të tjerat;
 - × -këmbimin e vazhdueshëm të përvojave, këmbimin e kuadrit akademik dhe të studentëve;
 - × -në bashkëpunimin më të madh me institucioneve të ndryshme ekonomike, shkencore e të tjera;
 - × -me avancim të punës shkencore dhe të asaj mësimore, që do të ndikonte në mësimdhënie dhe në mësimnxënie me efikase;
 - × - përtërirjen e kuadrit mësimoro-shkencor;

-
- ✘ - efektshmërinë më të madhe të studimeve (si rrjedhojë e zbatimit të planprogrameve të reja mësimore, të formave të reja të ligjërimit, të ushtrimeve, të mbikëqyrjes dhe të përcjelljes së punës së studentit dhe të vlerësimit të tyre, bashkëpunimit më të madh me organizatat për bërjen e punës praktike të studentëve etj.);
 - ✘ - **kompletimin e laboratorëve me pajisje të reja;**
 - ✘ - grumbullimin e informatave nga terreni lidhur me problemet me të cilat ballafaqohet infrastruktura rrugore, transporti, etj;
 - ✘ - **bashkëpunimin më të ngushtë me institucione relevante, në mënyrë që të mund të realizohet një pjesë e vetëfinancimit të veprimtarisë, etj.**

- × **Implimentimi i procesit të Bolonjës në Kolegjin “TEMPULLI”**

- ×

- × Sikurse në institucione tjera te shkollimit larte, poashtu edhe në Kolegjin “TEMPULLI”, procesi Bolonjës është pranuar me një entuziazëm, me qëllim të arritjes së standardeve evropiane për arsimin e lartë.

- × Në kuadër të KT, janë marrë hapat e nevojshëm me qëllim të përbushjes së standardeve në përputhje me Deklaraten e Bolonjës , pastaj, është zbatuar në një nivel të kënaqshëm sistemi i transferit të kredive ECTS, me tutje, janë rishikuar plan-programet mësimore dhe janë përpiluar plan-programet e reja sipas sistemit të studimit 3+2+3 dhe se fundi, është bërë publikimi në internet i planeve mësimore të detajuara ekzistuese .

-
- ✘ Ne kete kuader, duhet potencuar rrolin i Koordinatorit për ECTS. Përgjegjësi i Kolegjit për ECTS, paraqet një lidhje ne mes studentit dhe mësimdhënësit në fakultet, pastaj dhe merret me aspektet praktike të zbatimit të ECTS-se si dhe vepron si këshilltar për studentë. Ai studentëve, pastaj, iu ofron informacione për institucionet partnere, u ndihmon ne plotësimin e formularit për aplikim ne studime në universitetin partner, si dhe iu shpjegon mënyrën e pranimit akademik të lendeve mësimore etj.

- ✘

× Sigurimi i cilësisë

- × Kolegji “TEMPULLI”, është përcaktuar që në mënyrë sistematike dhe të organizuar të siguroj cilësinë e studimeve Bachelor dhe Master. Në përputhje me proceset e Bolonjës, në mënyrë kontinuale është duke u punuar në ngritjen e nivelit të cilësisë të të gjitha aktiviteteve që zhvillohen në Kolegj, procesit mësimor, sistemit të vlerësimit duke u bazuar në akumulimin dhe transferin e kredive sipas sistemit Evropian të ECTS, veprimtarive kërkimore – shkencore, sistemin e vlerësimit të cilësisë të mësimit nga ana e kandidatëve, cilësisë së literaturës, pajisjeve laboratorike, etj.

-
- ✘ Mekanizmat të cilat përdoren për sigurimin e cilësisë, mbeshteten në pyetësorët përmes të cilëve merren opinionet e Stafit Akademik dhe kandidatëve, ECTS formularët, syllabuset etj., Pra, në KT keto janë vlerësuar si mekanizma të një rëndësie të veçantë, përmes së cilëve mund të merren edhe opinionet për cilësinë e studimeve.

✘ **Struktura e studimeve MASTER**

- ✘ Struktura e studimeve është e organizuar në atë mënyrë që në dy semestrat e parë (shtatë dhe tetë), janë vënë lëndët profesionale të përgjithshme të cilat përfaqësojnë bazën mbi përvetësimin e disiplinave profesionale në transport. Në semestrin e nëntë (IX) ofrohen lëndët profesionale zgjedhore sipas profesionit. Në semestrin e dhjetë (X), aplikohet zbatimi i përvojës (stazhit), përkatësisht praktika profesionale dhe në fund, prezantohet puna hulumtuese në formë të projektit specialistik përmes të cilit studenti diplomon.

-
- ✘ Me qëllim të sigurimit të fleksibilitetit më të madh gjatë studimeve si dhe në bazë të dëshirës për arsimim në ngritjen e këtij profili profesional, krahas lëndëve mësimore të obliguara gjatë studimeve, studenti mund të zgjedhë lëndët (të paraqitura në Listën e lëndëve mësimore profesionale dhe të përgjithshme). Kjo do të thotë se, studenti është në fokus të studimeve. Studimet mund të regjistrohen si të rregullta dhe pa shkëputje nga puna.

✘ **PERFUNDIM**

- ✘ Ne kontekst të qëndrueshmërisë së ambientit më të favorshëm ekonomik, nga sfidat që e presin arsimin e lartë e që kanë të bëjnë me ofrimin e programeve akademike në fushën e trafikut dhe transportit, mendojmë se:
 - ✘ 1) programet mësimore duhet gjithnjë “t’i flasin kohës”, pra të jenë koherente si dhe shumë me dinamike (?),

-
- × 2) qe keto programe te jene edhe me kompatible ndaj arritjeve tekniko-teknologjike dhe shkencore ne nivelin global;
 - × 3) duhet te ndryshoje raporti ndermjet aspektit praktik dhe atij teorik te programeve mesimore, ne favor te ketij te parit,
 - × 4) ne kontekst te qëndrueshmërisë së ambientit më të favorshëm ekonomik, mendojme se, modulet programore duhet reduktuar ne masen sa me te vogel te mundshme,

-
- × 5) me qëllim të këmbimit të vazhdueshëm të përvojave, këmbimit të kuadrit akademik dhe të studentëve si dhe bashkëpunimit më të intensifikuar me ndërmarrje të ndryshme ekonomike, shkencore, e tjera, në vend dhe bote, shtrohet nevoja imediate për një mesimdhënie dhe mesimnxenie me të sforcuar të gjuhëve të huaja, të percjellura me programe të pershtatshme;

×

-
- ✘ 6) poashtu duhet arritur nje harmoni edhe me korekte te struktures programore si ne nivelin horizontal ashtu edhe ne ate vertikal, krejt kjo me qëllim që për një kohë relativisht të shkurtër studentet e posa diplomuar të jenë në gjendje t'u përgjigjen plotësisht kërkesave në mjediset dhe ambientet e punes.

×

FALIMINDERIT PER VEMENDJEN E JUAJ!